

Statistikat afatshkurtra

Shërbimet - Tremujori III 2021


Tiranë, më 15 Dhjetor 2021: Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 11,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 19,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




Transport, Magazinim dhe Postë

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 66,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 5,2 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 19,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)




Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje me rreth 2,2 herë, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 36,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 61,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)




Bar, Restorante

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 18,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 14,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Bar-Restorante (%)




Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 16,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 25,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 55,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig.5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)




Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 37,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 7,0 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 25,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekturore dhe Inxhinierike (%)




Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e tretë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje me rreth 2,1 herë, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 10,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 14,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2020.

Fig. 7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)



Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2015=100)

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.III 2021 (2015=100)	III.21/ III.20 (%)	Tr. III 2021 (2015=100)	III.21/ II.21 (%)
G	45+46 +47	Tregti	138,6	11,4	129,2	3,5
H	49-53	Transport dhe Magazinim	155,7	66,5	134,6	8,0
I	55,1	Hotele	409,5	123,8	260,9	14,4
I	56	Bar-Restorante	180,6	18,7	150,0	3,3
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	112,9	16,9	106,6	-6,0
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	123,5	-37,6	109,0	-46,4
N	79	Agjenci udhëtimi	162,3	109,1	154,4	67,3

Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2015=100)

NVE Rev,2			Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr III 2021 (2015=100)	III,21/ III,20 (%)	Tr III 2021 (2015=100)	III,21/ III,20 (%)
G	45+46+47	Tregti	119,3	2,9	144.8	19.7
H	49-53	Transport dhe Magazinim	120.2	5.2	135.6	19.6
I	55,1	Hotele	190.6	36.6	258.0	61.4
I	56	Bar-Restorante	131.5	1.8	173.3	14.4
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	126,3	25.9	153.5	55.1
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	125,9	7.0	177.3	25.3
N	79	Agjenci udhëtimi	121.8	10.9	152.2	14.4

Metodologjia

Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100,
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2019, realizuar nga INSTAT,
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante),

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt, Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore,

Në Shërbime

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete,

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100, Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute,

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor,

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë,

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit,

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj,

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjeve neto - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar,

Indeksi i Shitjeve neto - Objektiv i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime,

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

Indeksi i Numrit të punësuarve - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar,

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimeve (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese,

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën,

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2,2, Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori 1 2006 - Tremujori III 2021, Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative), Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit , komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme, Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore, Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte, Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive,